



In medias res

Barazia gjinore në tekstet shkollore

“Meshkujt dhe femrat janë si dy krahët e një zogu. Sikur një zog që nuk mund të fluturojë me një krah, ashtu edhe shoqëria nuk mund të zhvillohet, nëse meshkujt dhe femrat nuk zhvillohen në mënyrë të barabartë!”

Pabarazia gjinore është një pengesë mjaft e madhe në zhvillimin dinamik dhe të përshpejtuar të shoqërisë kosovare. Integrimi i Kosovës në familjen e shteteve të zhvilluar dhe demokratike është plotësisht i perealizueshëm me gjendjen dhe pozitën e tashme të gruas.

Në kohët e fundit, fal angazhimeve të mëdha të shoqërisë civile, të një kornize më të avancuar ligjore për mbrojtjen e gruas nga dhuna dhe format e ndryshme të diskriminimit, ka një arritje të shënuar në sensibilizimin e opinionit për barazinë gjinore. Në këtë sensibilizim, rol me rëndësi kanë loz dhe po lozin mjetet e informimit publik. Disa organizata joqeveritare të grave, me hulumtimet e veta, kanë zbardhur aspekte të ndryshme të pabarazisë së femrave në shoqërinë kosovare. Në këto hulumtime janë identifikuar edhe faktorët e shumtë që kanë pas dhe kanë implikime të fuqishme në pabarazinë praktike dhe jetësore të gruas Kosovare.

Para pak kohe, Qendra Kosovare për Studime Gjinore doli me një studim shumë serioz, në të cilën zbardhet çështja gjinore nga këndi i sistemit të tanishëm të arsimit.

Ajo që është më rëndësi të konstatohet dhe të bëhet plotësisht e qartë është se barazia gjinore asnjëherë nuk mund të arrihet me vendime administrative, me imponime e as me legjislaturë sa do e mirë që është.

Kjo mund të bëhet vetëm e vetëm përmes një sistemi të arsimit efikas dhe efektiv për të gjithë, pra edhe femrës. Duke u nisur nga ky konstatim, studimi i bërë nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore është shumë domethënës. Këto studime, të përforcuara edhe me shumë studime të tjera të zhvilluar në botë, tregojnë për rolin dominues të mashkullit në sistemin e arsimit. Ndër shtetet në të cilat janë bërë këto hulumtime veçojmë: SHBA, Shqipërinë, Indinë, Kroacinë, Malin e Zi, Serbinë. Këto studime tregojnë edhe një aspekt tjetër të pabarazisë gjinore. Ky aspekt, është se pabarazia e femrës me mashkullin, nuk është specifike e veçantë e një vendi, por është një problem global. Megjithatë duhet konstatuar se vendet që më së miri e kanë zgjedhë barazinë gjinore janë vendet më të zhvilluar në botë, sepse shoqëria ecën përpara me të dy krahët. Në të gjitha këto vende, pabarazia gjinore mëtohet të evitohet nëpërmjet arsimit cilësor për të gjithë, pra edhe të gruas, duke i luftuar paragjykimet dhe stereotipat gjinor në kurrikula lëndor, në libra të leximit dhe në tekstet shkollor në përgjithësi.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), duke e ditur këtë, se bashku me rrjetin grave të vendeve të rajonit “Women Action”, ka përfunduar një studim të gjerë dhe gjithëpërfshirës për barazinë gjinore në këto vende duke analizuar ndjeshmërinë gjinore të librave të leximit në arsimin e detyruar. Në këtë studim kemi konstatuar se librat e leximit nuk kanë ndjeshmëri të mjaftuar për barazinë gjinore, se në shumë elemente gjinia femërore është e diskriminuar dhe e pabarabartë, se sistemi i roleve familjare, i roleve profesionale dhe vlerave është ndërtuar mbi sistemin e stereotipave dhe të paragjykimeve. Kjo imponon nevojën për ndryshime të shumta në kurrikula dhe në tekste.

Shkroi: Halim Hyseni

¹Cit. nga studimi: Auditimi i çështjeve gjinore në sistemin e arsimit. Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë, 2006, f. 19

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

- Në kuadër të Programit të MKLSH më 10-11 mars në sh.f. "Hasan Prishtina", në Prishtinë është mbajtur seminari i gjashtë.

Strategjitë e reja të mësimdhënies dhe të nxënimit

- Me 10-11 mars ka përfunduar trajnimi në Cërmjan në kuadër të programit MKLSH dhe me këtë ka përfunduar trajnimi i atyre që kanë vazhduar trajnimin me vetëfinancim.

EKK (Edukimi kundër korrupsionit)

- Më 3-4 mars 2007 ka përfunduar trajnimi në Shtime, në kuadër të programit EKK. Trajnimin e ndoqën 20 mësimdhënës të lëndëve shoqërore, të cilët në fund të trajnimit u certifikuan.



- Me 10 mars, në kuadër të këtij programi, ka filluar trajnimi në Istog dhe Prishtinë. Trajnimi, ka vazhduar me datat 17-18 mars. Pas përfundimit të trajnimit ka filluar monitorimi i pjesëmarrësve

nëpër klasa. Në fund të këtij monitorimi, përkatësisht me datën 16 prill do të bëhet certifikimi i tyre.

Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin

- Më 1 mars është mbajtur tryeza e rrumbullakët në Prizren me temën "Roli i mediave në luftimin e korrupsionit", në të cilën morën pjesë 15 përfaqësues të mediave të Prizrenit dhe drejtorë shkollash. Tryeza, pati më shumë karakter informativ.

- Më 27-28 shkurt, nuk është mbajtur trajnimi në Pejë, për shkak se të pranishëm ishin vetëm 7 nga 42 të ftuarit që kishin konfirmuar pjesëmarrjen në trajnim. Rrethanat e krijuara imponuan që trajnimi të mbahet në Istog me 15-16 mars. Ky trajnim pati sukses, dhe u ndoq nga 31 pjesëmarrës, përfaqësues nga KK Istog, OJQ-të dhe biznesi.

- Me 20-21 mars është mbajtur trajnimi në Rahovec. Me 4-5 prill do të mbahet trajnimi në Mitrovicë, ndërsa me 18-19 prill do të mbahet trajnimi në Suharekë.

Masat anti-korrupsion në Arsim

Në kuadër të përgatitjeve për projektin "Masat anti-korrupsion në Arsim" të financuar nga ESP në Budapest, është realizuar një takim me përfaqësues të MASHT me qëllim të identifikimit të pjesëmarrësve në trajnim. Trajnimi do të mbahet me datat 24-27 prill 2007. Do të ketë rreth 40 pjesëmarrës të institucioneve të ndryshme, OJQ dhe nga shoqëria civile.

Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ Gjatë muajit mars programi “Edukimi për të Drejtat e Fëmijës”, ka përgatitur një program festiv me nxënësit e shkollës “Mileniumi i Tretë”. Programi u organizua në bashkëpunim me shkollën e Kitarës “Vihuela”. dhe është mbajtur në sallën e Teatrit “Dodona”, në Prishtinë. Programi u vlerësua shumë, si nga ana e organizatorëve. ashtu edhe nga ana e shikuesve.



■ Monitorimet për përdorimin e librave të botuar me ndihmën e ABA CEELI-t kanë përfunduar. Është përgatitur edhe raporti narrativ dhe i është dorëzuar ABA CEELI-t.

■ Në kuadër të projektit “Paragjykimet dhe Stereotipat gjinor në tekstet shkollore”, janë bërë tri punime të cilat janë në përfundim e sipër.

- Raporti për studimin e paragjykimeve dhe stereotipave gjinor të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulët;
- Raporti për studimin e qëndrimeve të mësimdhënësve për ndjeshmërinë e librave të leximit për barazi gjinore; dhe
- Analiza e librave të leximit nga aspekti i ndjeshmërisë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët;

Të gjitha këto punime janë dërguar në lekturë dhe në përkthim. Punimet do ti dërgohen donatorit deri në fund të muajit Mars.

■ Në programin “Edukimi Multi Kulturor dhe Multi Etnik”, është bërë përzgjedhja e 20 trajnerëve të cilët do ta ndjekin trajnimin për trajner I cili do të zgjas 7 ditë duke filluar nga muaji Prill. Po ashtu, është në përfundim e sipër edhe manuali për trajnimin e trajnerëve.

Hap pas Hapi

■ Më datat 26-30 mars, programi “Hap pas Hapi” mbajti trajnimin fillestar për klasat e para. Ky trajnim u mbajt në Prishtinë. Organizimi i këtij trajnimi ka shkuar shumë mirë dhe kishte një numër mjaft të madh të pjesëmarrësve.

■ Gjatë këtij muaji u mbajt një takim i grupit punues për parashkollorë. Gjatë këtij takimi u paraqit kërkesa për një kampanjë, që do të ndikonte në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e edukimit parashkollor. Me këtë rast nga programi HpH u kërkua që ta mbajë një trajnim për zyrtarë të arsimit nga ZRA dhe DKA.



■ Me 29 mars u mbajt takimi me kontakt persona në kopshtin Gëzimi Ynë, në Prishtinë. Edukatorët e kopshtit prezantuan projekt temat të cilat kanë pasur sukses sa i përket bashkëpunimit me

prindër. Kjo u prit me shumë interesim nga edukatorët e kopshteve tjera të Kosovës, dhe u caktuan temat me të cilat do të angazhohen për projekt tema në kopshtet përkatëse.

Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Edukimi për të Drejtën Shoqërore, është një program trajnimi i cili ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të pranuar diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, si vlerë njerëzore. Pranimi i të tjerëve pa paragjykime, të qënurit tolerant dhe i hapur, janë sjellje thelbësore të çdo qytetari, si dhe kusht për krijimin e një shoqërie demokratike. Një qasje e këtillë i mundëson çdo qytetari të drejtën për të qenë i pranuar dhe i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në aspektin individual, shoqëror dhe institucional.

Ky program u dedikohet punëtoreve të arsimit, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me relacionet njerëzore.

Gjatë javës së fundit të muajit mars Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) organizoi trajnimin e parë për të Drejtën Shoqërore. Trajnimi është mbajtur nga trajnerët vendor nën mbikëqyrjen e Prof. Nancy Smith nga Amerika.

Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 24 pjesëmarrës, kryesisht punëtorë të arsimit, por edhe nga fusha tjera.

Programi Edukimi për të Drejtën Shoqërore- trajnim për të rritur, ka dy module. Programi prezantohet në formë të punëtorisë dhe ka gjithsej 48 orë.



Trajnimet për Edukimin për të Drejtën Shoqërore do të mbahen në vazhdim edhe në 6 qendra tjera të Kosovës.

Strategjia Nacionale për Integrimin e Komunitetit RAE në Kosovë - Komponenta e Edukimit

■ Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) është angazhuar për ofrimin e asistencës teknike në procesin e hartimit të Strategjisë për përfshirjen e komunitetit RAE në Kosovë, në fushën e edukimit.

Grupi i punës për Komponentën e Edukimit, i menaxhuar nga KEC, pas një pune intensive tremujore ka hartuar draftin e parë të strategjisë për edukim. Drafti i këtij dokumenti do të jetë në diskutim publik deri më 30 prill 2007. Të gjitha palët e interesuara do të kenë mundësinë për dhënien e vërejtjeve dhe sugjerime.

Kjo komponentë e strategjisë do të jetë pjesë e Strategjisë Nacionale për Integrimin e Komunitetit RAE në Kosovë dhe strategjive tjera arsimore të Kosovës.

Përgatiti: Petrit Tahiri